

Data 15.11.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

“Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”.

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
31681410-0, 44115210-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 477 050 (tre milion e katërqindë e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. Formulari i Sigurimit të Ofertes sipas **Shtojcës 3**; Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 69.541 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqindë e dyzet e një) leke.

c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të ketë një

vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet përkatësisht **1 390 820 (një milion e treqindë e nëntëdhjetë mijë e tetëqindë e njëzetë)** lekë pa tvsh lëshuar nga autoriteti përkatës.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 “Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (**2021, 2022**) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore., të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen *edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese* Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars

të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (*vlera e pritshme e kontratave*) ose **695 410 (gjashhtëqindë e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqindë e dhjetë)** lekë pa tvsh. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, **b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

3. Kapaciteti teknik:

3.3.1. Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (të përkthyer dhe noterizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.ISO 9001: 2015 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë: Është një standart ndërkombëtarë i dedikuar për sistemet e menaxhimit të cilësisë, i cili përshkruan një kornizë në përmirësimin e cilësisë për çdo organizatë që kërkon të ofrojë produkte dhe shërbime konform kërkesave dhe pritshmërisë së klientëve/palëve të interesuara në mënyrë më efektive të mundshme. Ndër të tjera ky standart harmonizohet me objektivat dhe planet e RSU NR.1 në rritjen gjithnjë e më shumë të cilësisë në punët e përditshme dhe përafrimin me procedurat e ngjashme me vendet e tjera të zhvilluara.

b.Ofertuesi nepermjet nje deklarate duhet te deklaroje se merr persiper furnizimin e mallrave prane AK.

Argumentimi: nenit 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Keiter i cili vleresohet i nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

SPECIFIKIME TEKNIKE **PËR MATERIALET E NDËRTIMIT**

- 1.Materialet e ndertimit do te furnizohen sipas zerave te pasqyruara ne preventive .
2. Materialet inerte, çimento, gelqerja, do te furnizohen sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor brenda vitit .
3. Rera e betonit, rera e suvatimit duhet te jene materiale te kaluara ne makinerite e larjes dhe te pastrimit dhe pa permbajtje dherash.
- 4 .Gelqerja duhet te vije e ambalazhuar ne qese 10 kg dhe te jete e shuar dhe jo me permbajtje te larte uji.

5. Çimento duhet të jete sipas normativave dhe standarteve të miratuara e klases 32.5 N, e ambalazhuar në masen 0.25kv dhe e shoqeruar me dokumentin e dates skadences.
 6. Boja e vajit duhet të jete për lyerje materiale hekuri, e ambalazhuar në kuti 1kg . Ngjyrat e bojës duhet të jene sipas kërkesës së A.K
 7. Boja akrelik dhe hidromati duhet të jete e ambalazhuar në kova 5-15 kg
- Boja akrelike dhe hidromat duhet të plotesoje të gjitha parametrat teknike për lyerje të siperfaqeve të jshme dhe të brendshme dhe të jene të shoqeruara me fletën e dates së skadences.
8. Pigmentet do të merren të ambalazhuara në masen 0.5-1kg sipas ngjyrave të percaktuara nga AK në momentin e furnizimit.
 9. Stuko patinimi duhet të jete e ambalazhuar në masen 15 kg dhe e shoqeruara me fletën e skadences
 10. Pllakat e shtrimit duhet të jene të materialit për shtrim shatervani dhe me fortesinë për të duruar ujën.dhe në ngjyrë blu dhe me dizenjon sipas mostres që do të miratohet nga A.K
 11. Bordurat e betonit do të jene beton të armuar, në siperfaqe të niveluar mire dhe me ngjyrë gri , me permasa 1mx0.12 x 0.20 mm.
 12. Hekur ELE 10×10 duhet të jete në shufra me gjatesi 6 ml
 13. Tubi I hekurit duhet të jete me diameter 10 mm dhe furnizimi me gjatesi 6 ml.
 14. Leter katrama duhet të jet e granilizuar dhe me cilesi të larte.

CIMENTO, FINO, STUKO, BOJE VAJI, HIDROMAT, ALLÇI, PIGMENTE BOJAK, GRAFJATO, DUHET TË JENE ME FLETE SHOQERUSE SKADIMI TË MATERIALEVE.

Te gjitha materialet duhet të jene cilesore dhe përpara furnizimit duhet të miratohen mostrat për secilin material pastaj të behet furnizimi.

Veglat e punës do të jene sipas specifikimeve të shkruara në preventiv.

Veshjet e punës duhet të kene logon e Institucionit.

SPECIFIKIME TEKNIKE

PER MATERIALET QE NEVOJITEN PER SHERBIMIN "MARANGOZ"

VIDAT

- a- Vidat e drurit drurit duhet të jene të standart, të dimensioneve dhe sasive të paraqitura në pasqyrën bashkangjitur.

Adresa: Rruga: "Arben Broci", Qyteti Studenti, Tiranë, Tel/fax +355 4 2376 214/215/216 www.qytetistudenti.gov.al.

- b- Vidat (18 x 4) mm, nevojiten per montimin e menteshave te dollapeve e komodinave.
- c- Vidat (20 x 4) mm, nevojiten per montim bravash, doreza dyersh, kontrabra brava etj.
- d- Vidat (30 x 4) mm, nevojiten per riparim karikesh, tavolina, krevate druri, dollape, komodina etj.
- e- Vidat (40 x 4) mm, nevojiten pervec sa me siper per tavolina, krevate etj. por edhe per montim shina perdes, shina komodinash e dollapesh.
- f- Vidat (80 x 5,80x6) mm, nevojiten per fiksim etazheresh, montim stolash druri e te tjeta konstruksione te ambienteve te jashteme qe ndodhen ne kete ambient.

FIBRAT

Duhen sipas ngjyrave te meposhtme:

Ngjyre e bardhe tabak 5

Fibrat perdoren per veshje dyersh, fashatura, veshje shpina komodinash, shpina rafti, telajo, sypryna tavolinish e per nevoja te ndryshme te konstruksioneve prej druri.

Fibrat duhen ne dimensione standarte 240 x 180 cm.

BRAVAT AUTOMATIKE

Bravat e dyerve automatike duhet te jen te kompetuara ne kuti dhe fishek me nga 3-5 kopjo celsi. disa modele bravash duhet te jen 17cm te gjata modeli 735 dhe disa te tjera 13cm te gjata

Brave 17cm cope 70

Brave 13cm cope 50

MELAMINE

Melamina duhet te vi e gjitha ne ngjyre kafe, me dimensione 360 x 180 cm dhe me trashesi 16mm. Melamina perdoret per kapak dollapi, tavolina, komodina, etazhier, ndarese dollapi dhe sirtare.

GOZHDE E THUMBA

Te respektohen dimensionet 4-7 dhe sasia ne pasqyren bashkangjitur

SHKUMA

Duhet per fiksimin e kasave te dyerve te drurit. Per kete material duhet te respektohet patjeter afati i skadences ne ditën e furnizimit dhe ky afat te mos jete me I vogel se nje vit, per ndryshe te parashikohet furnizimi me afat.

DOREZA PER DYER (AUTOMATIKE DHE D/ALUMINI

Duhet te zevendesohen ne shume dyer ku bravat bravat dhe fisheku mund te jene ne gjendje te mire, por dorezat jane amortizuar ose keputur. Mos vendosja e tyre con ne prishjen e braves dhe te fishekut.

KUNDRABRAVAT

Sherbejne si fole e gjuhezes se braves.Duhet te zevendesohen ne shume dyer.kondrabravat duhet te jen per brava 17cm te gjata

TENIJA

Do te perdoret ne punimet e marangozit ne punimet me melamin.

MENTESHA DOLLAPI E KOMODINE

Do te perdoren per riparimin e kapakeve te dollapeve e komodinave.

MENTESHA DERE

Do te perdoren per zevendesimin e menteshave te dyerve ne rastet kur do te behet fiksimi I kasave me shkume ose ne rastet kur menteshat eksistuese keputen ose shtremberohen.Menteshat duhet te jen me hapje ne te dyja krahet dhe materiali te jet celik.

SHINA KOMODINE

Shinat e komodineve perdoren per komodina dhe dollapi,modeli i shinave duhet te jen modeli i shkurter.

DOREZA KOMODINE/DOLLAPI

Dorezat e komodinave dhe te dollapeve duhen te jen modeli rrumbullak dhe ngjyra te jet kafe.

SILIKON

Silikoni duhet te jet transparent dhe i nenshkruar ose i shoqeruar me date skadence

PROFIL HEKURI

Profili i hekurit duhet te jet me permasa 100x100mm dhe gjatesia e cdo profili duhet te jet 6ml

DISQE SHARRE

Disqet e sharres duhet te jen materialit celik per dru dhe per melamin.

Disk sharre per prerje druri me diameter 30cm (300mm) cope 2

Disk sharre per prerje melamine me diameter 30cm (300mm) cope 2

SHKALLE ALUMINI

Shkala duhet te jet e materialit alumin dhe me hapje.permasa e shkalles duhet te jet 300cm e hapur me 10 shkelje dhe hapje (palosje 60 °.

MEKANIZEM ANTIRIBAL

Mekanizmi antiribal duhet per dritaret duralimini I godines nr.11-12.para se te sillet mekanizmi duhet marre nj model tip I godines si moster.

VIDIATOR

Vidiatori duhet te jet me bateri 18V.duhet te shoqerohet me kutin perkatese.me dy bateri dhe nj karikues dhe me nj set kokash kacavidash.

MATRAPIK

Matrapik 1600w 800-1200rpm (me slic) per te hapur mure per punime elektrike-hidraulike

KANGJELL LIDHESES

Kangjell lidhese, per skele suvatimi, me diomensione 1.8mm, Ø25mm, 250cm x 60cm.Duhet per te montuar te skelat e suvatimit per te garantuar sigurine e puntoreve ne lartesi.

MENTESHA KREVATI

Menteshat duhen per fiksimin e krevatave ne godinen nr.1. Menteshat duhet te jen metalike dhe me permasa 120x45mm.

Adresa: Rruga: "Arben Broci", Qyteti Studenti, Tiranë, Tel/fax +355 4 2376 214/215/216 www.qytetistudenti.gov.al.

SET PUNTO DRURI

Puntot e drurit duhet te jen material celik,seti te ket permasat e puntos 3-10mm

SFUNGJER

Sfungjeri duhet te ket nj tashesi prej 2cm,perdoret per veshje karrige dhe veshje tapicerie.

METER SHIRIT

Meter shirit I cili duhet te bej matje deri ne 5ml.dhe trashesua te jet 19mm

RROTA SKELE

Seti duhet te perbehet nga 4 cope rrota rrotulluese me konstrukcion metalik,me kushinet rrotulluese dhe gomate te jen mishi.

VIDA SKELE

Vidat duhet te ket nje trashesi prej 3mm,gjatesia 70cm.Vida duhet te jet per skele betoni.

KEMBE SKELE

Kembet e skeles duhet te jet per skel betoni/suvatimi.me dimensionet 2.5 mm, Ø 48mm, 2 x1.2m

KRAHE HIDRAULIK

Krahe hidraulik I materialit aliazh I derdhur per mbylljen e dyrve te emergjences deri ne 30kg force terheqje.

JELEK FOSFORISHENT

Jeleket duhet te jen ngjyre e verdhe fosforishente me logon ne pjesen e pasme RSU.Nr.1

GRILA PERSIANE

Grila persiane I materialit duralumin me dimension 140x150 I ngjyre te kuqe ose te verdhe,te jen nj trup me rreshkitje.mevojten per godinen 11-12.

PEDANE E GALAZHANIVUAR

Pedane e galavanizhuar per skela ndertimi (suvatimi) me dimensione 50cm x 250cm

KARROCE TRANSPORTUESE MAGAZINE.

Karroca duhet te jete per pesha 150 kg per transport mallrash te ndryshme, duhet te jete konstrukt metalik te forte dhe doreza metalike te rrethuar me gome.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike hartohen nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Një nga detyrat funksionale të Drejtorisë së Shërbimeve Mbeshtetese është të kujdeset për mirëmbajtjen e godinave të RSU Nr.1. Për ushtrimin e detyrave funksionale stafi i mirëmbajtjes ka nevoja për pajisjen me materialet e domosdoshme te ndertimit dhe marangozerise. Materialet e ndertimit dhe marangozerise duhet të jenë sa më cilësore, ti përshtaten tërësisht specifikimeve teknike të kërkuara nga AK.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **27.11.2023, ora 12:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale ndertimi dhe marangozerie”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

KOMISIONI